



**FESTIVALI I ARTIT  
NË HAPËSIRË PUBLIKE**

**EDICIONI I TETË**

**23-25 qershor 2022**





## A je në tokë të bukës?!

Të dashur miq e dashamirë të Tokës, ujit e ajrit,

Pas një periudhe tejet të vështirë këtë vit po qesim hapat e ngadaltë duke u munduar të kthehemi e të vazhdojmë aty ku e lamë para Pandemisë botërore të vitit 2020 e 2021. Por siç duket kjo shkundje na ka shkundur edhe vetëdijen tonë mbi atë se ku po jetojmë e si po jetojmë, si po e trajtojmë planetin tonë e si po e trajtojmë edhe vetveten e njëri tjetrin. Detyrimisht po fokusohemi te qenësorja, te ajo që është bërthama e të qenurit tonë, neve, banorëve të Tokës e pjesëtarëve të njerëzimit.

Por, ajemi vonë? Ajemi në tokë të bukës?

Këto dhe pyetje tjera po përpiqen të gjejnë përgjigje apo të shtojnë edhe më shumë pyetje përmes programit të këtij edicioni të tetë të Festivalit HAPU. Artisët pjesëmarrës po vendosin pika neurologjike në dy parqet e Prishtinës, Pakun e Qytetit dhe Taubashçe për të dialoguar me Tokën e me banorët e saj. Për të ngritur këto çështje e ato që ndërlidhen po përdoret: gjuha e muzikës e tingullit, gjuha e shenjave e gjuha trupore, dërrasa e zezë, gjesti, rekuizita e pothuajse gjithçka që narrethone që peshon mbi Tokë.

Ju ftojme të na bashkangjiteni në këtë eksplorim përmes artistëve, pjesë e punës tonë të përbashkët dhe bashkëpunimit në nivelin evropian me partnerët tanë në kuadër të IN SITU. Ju ftojme të hapeni me Tokën, ujin e ajrin dhe me gjithçka tjetër jo-njerëzore që bashkë-ekziston me ne. Ju ftojme ta ri-mendojmë rolin e sjelljen tonë si bashkë-banorë të kësaj Toke.

Florent Mehmeti, Drejtor Artistik, HAPU – Festivali i Artit  
në Hapësirë Publike

# PROGRAMI

## E enjte, 23 qershor 2022

Koha	Programi	Lokacioni
21:00 ----- 21:30	Donika Rudi - <b>LAMENT OF THE EARTH</b> (Vajtimi i Tokës) <i>Cikël i veprave audio-vizuale, kushtuar efekteve të ndryshimeve klimatike në Tokë, ngrahjes globale dhe eksperiencës tingullore për komunitetin e shurdhët.</i>	PQ
22:00	<b>HAPJA E FESTIVALIT</b> <i>Nën tingujt e natyrës dhe duke qëndruar së bashku ngremë një dollë për hapjen me natyrën dhe me jo-njerëzoret tjerë me të cilët bashkëbanojmë në Tokë.</i>	PQ

## E premte, 24 qershor 2022

Koha	Programi	Lokacioni
11:00 dhe vazhdon të qëndrojë instalacioni	Driton Selmani - <b>"WEATHER FORECAST", 2022</b> (Parashikimi i Motit) <i>Dimensionet: 330 x 250 cm</i> <i>Dërrasë e zezë e përdorur, ngjyrë akrilike, korniza druri.</i>  <i>Një instalacion në thellësi të pyllit, ku arkivimet e ngjarjeve historike apo edhe ato personale mbajnë gjallë kujtesën.</i>	TKB
16:00 ----- 18:00	Eva Bubla - <b>"AROMA MAPPING" (HUNGARI)</b> <i>PUNËTORI:</i> <i>Një punëtori për të eksploruar bashkërisht pjesën e Parkut të Taulkashçes duke përdorur trupin dhe shqisat tona të nuhatjes, duke kërkuar profilin unik aromatik të qytetit dhe fabulën e tij.</i>  <i>Ju lutem rezervoni vendin tuaj duke na shkruar email në <a href="mailto:teatrioda@gmail.com">teatrioda@gmail.com</a> me shënimin për ditën dhe kohën e punëtorisë që dëshironi të merrni pjesë.</i>	TKB
19:00	Agnes Nokshiqi, Donikë Ahmeti & Don Shala <b>"DASHURIA PËR ..."</b>  <i>Performancë artistike e 3 artistëve që shtjellon mënyrën tonë të trajtimit të Tokës. Pikëpyetjet artistike se çka bëjmë e çka themi kur flasim për Tokën, mjedisin, ajrin e ujin?</i>	PQ
21:00 ----- 21:30	Donika Rudi - <b>LAMENT OF THE EARTH</b> (Vajtimi i Tokës) <i>Cikël i veprave audio-vizuale, kushtuar efekteve të ndryshimeve klimatike në Tokë, ngrahjes globale dhe eksperiencës tingullore për komunitetin e shurdhët.</i>	PQ

## E shtunë, 25 qershor 2022

Koha	Programi	Lokacioni
vazhdon të qëndrojë instalacioni	<b>Driton Selmani - "WEATHER FORECAST", 2022 (Parashikimi i Motit)</b> <i>Dimensionet: 330 x 250 cm</i> <i>Dërrasë e zezë e përdorur, ngjyrë akrilike, korniza druri.</i>  <i>Një instalacion në thellësi të pyllit, ku arkivimet e ngjarjeve historike apo edhe ato personale mbajnë gjallë kujtesën.</i>	<b>TKB</b>
16:00	<b>Eva Bubla - "AROMA MAPPING" (HUNGARI)</b> <i>PUNËTORI:</i> <i>Një punëtori për të eksploruar bashkërisht pjesën e Parkut të Taukbashçes duke përdorur trupin dhe shqisat tona të nuhatjes, duke kërkuar profilin unik aromatik të qytetit dhe fabulën e tij.</i>	<b>TKB</b>
18:00	<i>Ju lutem rezervoni vendin tuaj duke na shkruar email në <a href="mailto:teatrioda@gmail.com">teatrioda@gmail.com</a> me shënimin përditën dhe kohën e punëtorisë që dëshironi të merrni pjesë.</i>	
19:00	<b>Haveit - "JEPI ME GOJË"</b> <i>Konstruksion i një mjedisi ku ushqimi, familja dhe dashuria tentojnë t'japin skllavërisë një kuptim të ri.</i>	<b>TKB</b>
20:00	<b>Koncert i mbylljes së HAPU për këtë vit.</b> <b>"KREJT SUPER!"</b> <i>Performorojnë SYTË, La Fazani, Zwada Sahati dhe Oda Haliti</i> <i>Jo bash rock, as pop, as elektronikë apo hip-hop, por krejt ka pak dhe KREJT SUPER!</i>	<b>TO</b>

## LOKACIONET

### Lokacionet e Festivalit - Prishtinë

<b>PQ</b>	<b>Parku i Qytetit</b> <a href="https://goo.gl/maps/ZdFdhYTdBiemnXBr8">https://goo.gl/maps/ZdFdhYTdBiemnXBr8</a>
<b>TKB</b>	<b>Parku i Taukbashçes</b> <a href="https://goo.gl/maps/WsYZHuBA5TnTjNqb6">https://goo.gl/maps/WsYZHuBA5TnTjNqb6</a>
<b>TO</b>	<b>Teatri ODA - Pallati i Rinisë, nr. 111 (rr. Rinia, 7)</b> <a href="https://goo.gl/maps/z3nEUeZz3UE2">https://goo.gl/maps/z3nEUeZz3UE2</a>



## Platforma evropiane për krijimtari artistike në hapësira publike

IN SITU është Platforma evropiane për krijimtari artistike në hapësira publike. Udhëhiqet nga Lieux Publics, qendër nacionale dhe evropiane për krijim artistik në hapësirë publike e vendosur në Marsejë (Francë). Që nga viti 2003, ka përkrahur më shumë se 270 artistë që punojnë jashtë sallave konvencionale dhe që kontribuojnë në transformimin e territoreve tona. IN SITU është një ekosistem që lidh gjeneratën e re të artistëve me publikun, programuesit dhe akterët kyç të përfshirë në realitetet ekonomike, politike e sociale rreth e përqark Evropës.

IN SITU bashkon 19 partnerë nga 13 vende: Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Franca, Hungaria, Italia, Kosova, Holanda, Norvegjia, Spanja, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

IN SITU gjithashtu bashkon edhe 13 partnerë të asocuar nga Belgjika, Franca dhe 9 vende tjera: Kina, Finlanda, Gjermania, Lituania, Portugalia, Sllovakia, Koreja e Jugut, Sri Lanka dhe Tajvani. Projekti (UN)COMMON SPACES 2020 – 2024 është bashkë-financuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian.

Ky komunikim reflekton qëndrimet vetëm të autorëve dhe Komisioni nuk mbanë përgjegjësi për çfarëdo përdorimi të informatave që përmban ky komunikim.



**E enjte, 23 qershor 2022** 

në orën 21:00 dhe 21:30 (Parku i Qytetit)

**E premte, 24 qershor 2022** 

në orën 21:00 dhe 21:30 (Parku i Qytetit)

**Donika Rudi**

# **LAMENT OF THE EARTH**

**(VAJTIMI I TOKËS)**

Është cikël i veprave audio-vizuale nga kompozitorja Donika Rudi kushtuar efekteve të ndryshimeve klimatike në Tokë, është thirrje për ndërgjegjësim dhe kujdes ndaj planetit tonë. Fokusi thelbësor i këtij cikli është shtjellimi i temës së ndryshimeve klimatike dhe eksperiencës tingullore për komunitetin e shurdhët.

Vepra është ndërtuar duke u bazuar në grafikën e “warming stripes” apo shiritat e ngrohjes globale, të cilat vizuelisht portretizojnë ndryshimin afatgjatë të temperaturës në sipërfaqen e Tokës. Në pjesën e parë vepra përqendrohet në tinguj organikë, kryesisht në një qetësi dhe harmoni me tekst të autores Doruntina Basha, përderisa kulminacioni arrihet me tinguj të transformuar, të deformuar dhe vajtimin e tokës, thirrjes për veprim nga sopranoja Kaltrina Miftari. Gjuha e shenjave dhe vallëzimi është pjesë integrale e këtij cikli, ku përmes lojës së lëvizjeve, vallëzimit dhe “visual vernacular” do interpretohet dhe përjetohet emocioni i tingullit. Vepra adreson atë që të gjithë ndjejmë por nuk e flasim, vërejmë por nuk e shohim, atë që na afekton por ne qëndrojmë indiferent. Çdo qenie e gjallë është pjesë përbërëse e Tokës, si të tillë lindim prej saj dhe kthehemi tek ajo. Kjo vepër është medium në mes të dëgjuesit dhe gjenomit të tij të humbur prej kohësh, pasi përpiqet të eksplorojë ekzistencën e secilit prej nesh me një thirrje, një thirrje për të dëgjuar dhe vepruar, para se të jetë tepër vonë.

Ajo foli, a e dëgjuam?

Ajo pyeti, por a u përgjigjëm?

Ajo gulçoi, por a belbëzuam?

Jemi, derisa ajo të jetë!





**Donika Rudi**, kompozitore  
**Kaltrina Miftari**, soprano  
**Agnes Nokshiqi**, visual vernacular & vallëzim  
**Doruntina Basha**, teksti  
**Hana Zeqa** (Fight or Flight), kostumi / skenografia  
**Samire Jupolli**, konsulente për gjuhën e shenjave  
**Labinot Rudi**, sound / zëri

<http://donikarudi.com/>



Co-funded by the  
Creative Europe Programme  
of the European Union



*Donika Rudi është artiste e asocuar e IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahet nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), Fira Tàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 4 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinarte, Pergine Festival, Teatro Stabile Di Sardegna.*



**E premte, 24 qershor 2022** 

në orën 16:00 dhe 18:00 / Taukbashçe

**E shtunë, 25 qershor 2022** 

në orën 16:00 dhe 18:00 / Taukbashçe

Eva Bubla (HUNGARI)

## **AROMA MAPPING**

Qyteti na shpaloset përmes shqisave. Ne mund të eksplorojmë mjedisin tonë, ritmin e tij, atmosferën, teksturën, si dhe gjendjen aktuale të tij përmes shikimit, zërit, prekjeve, shijes dhe nuhatjes. Sidoqoftë, kohëve të fundit, shikimi është bërë mjeti mbizotërues për zbulim, duke mënjeluar mënyrat e tjera të eksplorimit dhe lidhjes shqisore. Po sikur të mbyllnim sytë dhe të ktheheshim tek ato shqisa?

Cilat lloje të aromave i japin formë Prishtinës? Çfarë lloj agjentësh njerëzorë dhe jo njerëzorë, faktorë mjedisorë apo socialë, cilat aktivitete e përcaktojnë atë? Çfarë rrëfimesh mund të na shpalosin erërat dhe aromat?

Gjatë punëtorisë ne eksplorojmë zonën përreth duke përdorur trupin dhe shqisat tona të nuhatjes, duke kërkuar profilin unik aromatik dhe fabulën e qytetit.

*Kohëzgjatja e punëtorisë: 60-90 minuta*

*Numri i pjesëmarrësve i kufizuar për seancë.*

*Ju lutem rezervoni vendin tuaj duke na shkruar email në [teatrioda@gmail.com](mailto:teatrioda@gmail.com) me shënimin për ditën dhe kohën e punëtorisë që dëshironi të merrni pjesë.*

*Punëtorija mbahet në gjuhën angleze me përkthim në shqip.*

*Ju lutem vishni diçka të përshtatshme dhe të lehtë për të lëvizur.*



<http://evabubla.art/>



Co-funded by the  
Creative Europe Programme  
of the European Union



*Eva Bubla është artiste e asocuar e IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahët nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), Fira Tàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 4 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinarte, Pergine Festival, Teatro Stabile Di Sardegna.*

**E premtë, 24 qershor 2022** 

prej orës 11:00 dhe vazhdon të qëndrojë instalacioni / Taukbashçe

**Driton Selmani**

# **WEATHER FORECAST, 2022**

## **(PARASHIKIMI I MOTIT)**

*Planeti Tokë është një lajm i vjetër. Është shtëpia që po e hedhim posht'. Ne definitivisht nuk e duam atë. Ne pothuajse besojmë se nuk kemi nevojë për të.<sup>1</sup>*

Duket sikur pyjet dalin të jenë libra të fshehur, ku çdo pemë përbëhet nga një faqe e bardhë e pastër. Në pritje të një poeme tjetër që do të shkruhet në to si " dëshmi" dhe bazë për çdo rrëfim që i përket të së kaluarës.<sup>2</sup>

Duke u futur në mes të marrëdhënies midis natyrës dhe njerëzve dhe duke përdorur pyllin e thellë si formë referimi për të rrëfyer dhe konstruktuar historinë e kohës sonë, projekti do të përpiqet të vërë në dyshim koston e asaj që ne nuk jemi të gatshëm të paguajmë.

Vendosja e një dërrasë të përdorur të shkollës, në thellësi të pyllit, ku regjistrimet e ngjarjeve historike apo edhe ato personale do të jenë një udhërrëfyes për të mbajtur gjallë kujtesën, për një brez kompleks, por gjithashtu edhe për t'i bërë të pashlyeshme shkrimet mbi to. Si dëshmi dhe mësim të nevojshme për të balancuar historinë e së ardhmes mes njeriut dhe vetë natyrës.

1) 100 Notes – 100 Thoughts / N°006: Etel Adnan, The Cost for Love We Are Not Willing to Pay, (DOCUMENTA 13, 2011)

2) Paul Ricoeur, La Mémoire, l'Histoire, l'Oublie (Paris: Seuil, 2000).

<https://dritonselmani.com/>



**E premtë, 24 qershor 2022** 

në orën 19:00 / Parku i Qytetit

**Agnes Nokshiqi, Donikë Ahmeti & Don Shala**

## **DASHURIA PËR ...**

Performancë artistike e 3 artistëve që shtjellon mënyrën tonë të trajtimit të Tokës, përditshmërinë tonë e sjelljet tona duke vënë një pikëpyetje të madhe se për kë është dashuria? Çka bëjmë e çka themi kur flasim për Tokën, mjedisin, ajrin e ujin? Pikëpyetjet artistike të sjelles e dashurisë sonë gjejnë formën e gjuhës së trupit. Pikëpyetjet ngjallin raportin tonë me rekuizitat e përditshmërisë, me Tokën ku qëndrojmë, ushqehemi e jetojmë.

Pikëpyetjet e transformimit të Planetit tonë duke iu falënderu "dashurisë" njerëzore ngërthehen në gjetet dhe lëvizjet e performuesve. Aty, mbi tokë, mbi Tokën që na mban të gjallë, mbi Tokën ku dashurojmë apo pretendojmë të dashurojmë.

<https://www.instagram.com/agnesnokshiqi>





**E shtunë, 25 qershor 2022** 

në orën 19:00 / Taukbashçe

Haveit

# JEPI ME GOJË

“Jepi me gojë” ndodh në parkun e Taukbashçes, ku Haveit konstruktojnë një mjedis të ftohtë, monoton, megjithatë një mjedis i njohur ky, ku ushqimi, familja dhe dashuria tentojnë t'i japin skllavërisë një kuptim të ri, tash dhe përgjithmonë.

<https://www.facebook.com/haveit/>

<https://www.instagram.com/haveit>



**E shtunë, 25 qershor 2022** 

në orën 20:00 / Teatri ODA

Koncert i mbylljes së HAPU për këtë vit

# KREJT SUPER!

Performorojnë SYTË, La Fazani, Zwada Sahati dhe Oda Haliti.

Jo bash rock, as pop, as elektronikë apo hip-hop, por krejt ka pak dhe KREJTSUPER!



**KREJT SUPER!**

**25 QERSHOR 2022**  
TEATRI ODA

**SYTË**  
**LA FAZANI**  
**ZWADA**  
**SAHATI**

AFTER HOURS WITH  
**ODA HALITI**

TICKET: 5€

  

TICKETS AT  
DIT' E NAT'



**HAPU – Festivali i Artit në Hapësirë  
Publike organizohet nga Teatri Oda:**



TEATRI  
O D A

**Pallati i Rinisë, 111 (Rinia, 7),  
10030 Prishtinë, Kosovë**

**www.teatrioda.com**

**T: +383 38 246 555**

**M: +383 49 246 555**

**E: oda@teatrioda.com**

**f i teatrioda**

**Drejtor Artistik:** Florent Mehmeti

**Ekipi i festivalit:** Daniela Markaj (koordinatore),  
Flutura Çelaj, Martina Shtufi

**Ekipi teknik:** Yann Perregaux-Dielf,  
Mursel Bekteshi, Bujar Bekteshi

**Administrata:** Lumnije Komoni

**Ky publikim reflekton qëndrimet vetëm  
të autorëve. Donatorët dhe mbështetësit  
nuk mbajnë përgjegjësi për çfarëdo  
përdorimi të informatave që përmban  
ky publikim.**

**hapu.me**

**f i hapufest**

**Mbështetur nga:**



Co-funded by the  
Creative Europe Programme  
of the European Union



**Republika e Kosovës**  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



KOMUNA E  
PRISHTINËS

**ADS D-LINE**  **VM3**

**Partner medial:**

**KOHA**